

Nr. 538
dt 07.02.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Pin. shijecw
Bordit të Adverit.
Këshillit Akademik
Këshillorin

Nr. 1036 Prot.

Tiranë, më 02.02.2020

Lënda: Mbi zbatimin e VKM-së nr.778, datë 26.12.2018.

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.3, Tiranë

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi Nënë Tereza Nr. 4, Tiranë

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Pajsi Vodica", Kodër Kamëz, Tiranë

UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2 Tiranë

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", Tiranë

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Sheshi 2 Prilli 24, Shkodër

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Adresa: Rruga "Ismail Zyra", Elbasan

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Adresa: Skelë, Rruga Kosova, Vlorë 9401

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Adresa: Bulevardi "Rilindasit 1", Korçë

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastër

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

Adresa: 14, 2001, Rruga Currila, Durrës

Të nderuar administratorë,

Është kërkuar nga ana juaj interpretimi për VKM-në nr.778, datë 26.12.2018 "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të

studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar” dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ju ka kthyer përgjigje disa herë.

Duke marrë parasysh që ende ka paqartësi dhe mosunifikim të praktikave për zbatimin e VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018 nga institucionet publike të arsimit të lartë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë çdo interpretim të dhënë për IAL-të publike për këtë çështje e konsideron të pavlefshëm dhe ju kërkon të merrni parasysh vetëm këtë shkresë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk përcakton rregullat për kalimin e studentëve nga njëri vit akademik në tjetrin, apo ato për përlogaritjen e notës mesatare të secilit student.

Për këtë arsye, VKM-ja nr.778, datë 26.12.2018, zbatohet sipas rregullave të brendshme të IAL-ve publike, duke respektuar përcaktimin që, nga viti i dytë akademik dhe në vijim studentët duhet të kenë notë mesatare të paktën 6 (gjashtë). Mënyra e përlogaritjes së notës mesatare, me provime të mbartura apo jo, është vendim që duhet të merret nga organet drejtuese të IAL-ve publike.

Një shembull i mirë i zbatimit të vendimit të sipërcituar, është Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, i cili në kuadër të autonomisë së tij, e ka zbatuar përmes procesit të vendimmarrjes nga organet e tij drejtuese.

Me respekt,


REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISE
TIRANE
MINISTRI
Besa SHAHINI